EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5717
E martë, 5 mars 2019
çmimi 0.40 €

Ministrja Hoxha: Nuk kemi humbur asnjë cent nga fondet IPA

FAQE 7

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", JAKUP KRASNIQI FAQE 4-5

PA EPOPENË E JASHARËVE S'DO TË KISHIM LIRI DHE PAVARËSI

- 21 vjet pas 'Epopesë së UÇK-së' fitorja është e madhe, ndonëse jo e plotë

Ish-zëdhënësi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), historiani Jakup Krasniqi, me rastin e shënimit të 21-vjetorit të 5, 6 dhe 7 marsit të vitit 1998, ka thënë se pa epopenë e Jasharëve në Kosovë nuk do të nxehte dielli i lirisë dhe pavarësisë. Për më shumë se dy dekada pas kësaj ngjarje të rëndësishme për vendin dhe kombin shqiptar, ai ka thënë se fitorja është e madhe, por jo e plotë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Krasniqi ka deklaruar se Prekazi i Poshtëm dhe Lagjja e Jasharëve janë bërë qendra të pelegrinazhit për të gjithë shqiptarët, ndërsa Adem legjendari, kryesimbol i lirisë dhe i pavarësisë sonë. Ai ka thënë se është koha që institucionet shtetërore t'i kushtojnë vëmendje të shtuar dhe serioze Kompleksit Memorial "Adem Jashari", që është bazamenti i lirisë dhe i shtetit tonë

MUSTAFA: E VETMJA ZGJIDHJE JANË ZGJEDHJET E REJA

FAQE 3

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka vlerësuar se vendi ka hyrë në një qorrsokak dhe e vetmja rrugëdalje janë zgjedhjet e reja. Në një konferencë për medie, të mbajtur të hënën, Mustafa ka thënë se vetëm pas marrjes së legjitimitetit të ri nga qytetarët, institucionet e vendit do të mund t'i kryejnë detyrimet e veta kushtetuese, duke përfshirë edhe dialogun me Serbinë

Veseli: Asnjë qeveri nuk mund t'i rrezikojë raportet e shenjta me ShBA-në

FAQE 7

AKTUALE

KUJDES ME ETIKËN KUR RAPORTOHET PËR RASTE TË NDJESHME

F. 11

Nga Musa SABEDINI

SBASHK-U DO TË DORËZOJË PADI PËR KOMPENSIMIN E ORËVE TË HUMBURA

F. 6

EKONOMI

THELLOHET BASHKËPUNIMI NË MES TË BANKËS QENDRORE TË KOSOVËS DHE ASAJ TË TURQISË

F. 9

KEK-u ME MODERNIZIM TË 'KOSOVËS B' RRIT PRODHIMIN EDHE PËR 60 MEGAVATË

F. 9

KULTURË

50 TË RINJ PËRFITOJNË NGA MKRS-ja PËR PUNË PRAKTIKE NË TURQI

F. 12

SPORT

HALILAJ, SHTETIT: NA KRIJO HAPËSIRË, SE KEMI TALENT QË PËRFAQËSOJNË KOSOVËN

F. 16

VAZHDOJNË AKUZAT NË MES TË PRISHTINËS DHE LLAPIT, PËRMENDEN NDËRTIMTARIA DHE KAZINOTË

F. 16

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
KOLEGJI BIZNESI · BIZNESI COLLEGE · PRISHTINË 2004
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Reeker i bën thirrje Kosovës për ta hequr taksën

SHKUP, 4 MARS - Ndihmëssekretari i ardhshëm i Shtetit për Evropën dhe Azinë, Philip Reeker, u bëri edhe një herë thirrje autoriteteve të Kosovës ta pezullojnë taksën doganore të vendosur ndaj Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës, në mënyrë që t'i hapet rrugë dialogut dhe arritjes së marrëveshjes Kosovë - Serbi. Këto komente diplomati amerikan i bëri në Shkup, ku po merr pjesë në një seminar dyditor për sigurinë, raportet rajonale dhe zhvillimin ekonomik, "Ballkani 360".

Reeker tha se "normalizimi i marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë në kornizën e dialogut që po udhëhiqet nga BE-ja është një mundësi e mirë për zgjidhjen e problemit që cungon gjithë Ballkanin". "Nëse Prishtina zyrtare nuk kthehet në negociata siç ka thënë 'pa kushte', atëherë do të rrezikojë të ardhmen evropiane dhe jo vetëm", tha zyrtari i lartë amerikan.

Kosova, nënvizoi ai, nuk humb asgjë nëse negocion, por "mund të rrezikojë gjithçka nëse nuk ulet në tryezën e bisedimeve". Reeker ftoi edhe Beogradin, i cili, sipas tij, ka qenë agresiv në negociata, të angazhohet për normalizimin e marrëdhënieve.

Hale vjen në Kosovë, nxit arritjen e marrëveshjes me Serbinë

Zëvendësekretari amerikan i Shtetit, David Hale, do të qëndrojë më 8 dhe 9 mars në Beograd dhe Prishtinë, për t'i nxitur të dyja palët që të ulen në tryezën e bisedimeve, për të arritur një marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve

PRISHTINË, 4 MARS - Zëvendësekretari amerikan i Shtetit, David Hale, do ta vizitojë Kosovën më 9 mars, ndërsa një ditë më herët do të qëndrojë në Beograd. Vizita e tij në Beograd dhe në Prishtinë ka për qëllim që t'i nxisë të dyja palët që të ulen në tryezën e bisedimeve për të arritur një marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve.

Në një njoftim të Departamentit amerikan të Shtetit, thuhet se "në Beograd ai do të bisedojë me zyrtarët serbë për marrëdhëniet dypalëshe dhe do ta nxisë kthimin në tryezën e bisedimeve për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën. Ai do të diskutojë edhe me drejtuesit e shoqërisë civile për çështje rajonale dhe globale, përfshirë ndikimin rus dhe kinez në Ballkanin Perëndimor".

Më pas, më 9 mars, në Prishtinë, ai do t'i takojë udhëheqësit e lartë të Kosovës për ta nënvizuar mundësinë historike për të arritur një marrëveshje të plotë të normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë dhe për të kërkuar masa për të arritur një zgjidhje.

Hale, i cili më parë qëndroi në Londër dhe në Ukrainë, është zyrtari më i lartë amerikan që kohët e fundit viziton Kosovën për t'i nxitur autoritetet që ta hapin rrugën për vazhdimin e bisedimeve me Serbinë, të cilat janë pezulluar për shkak të kushtëzimit të tyre nga Beogradi me pezullimin e tarifave ndaj mallrave serbe që u vendosën nga Qeveria e Kosovës në nëntor të vitit të kaluar.

Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, emëroi David Hale për nënsekretar më 30 gusht të vitit të kaluar, ndërsa ai më herët kishte kryer detyrën e emisarit të ShBA-së në Pakistan dhe Liban dhe ishte emisar special për bisedime paqësore për Lindjen e Afërt.

Javën që lamë pas, dy zyrtarë të lartë të Këshillit Kombëtar të Sigurisë qëndruan për dy ditë në Kosovë për ta siguruar pezullimin e tarifave, ndërsa paralajmëruan shtimin e masave ndëshkuese nëse Kosova vazhdon t'i refuzojë kërkesat e tilla.

Kërkesat e amerikanëve kanë nxitur përplasje të brendshme në Kosovë ndërmjet atyre që ngulin këmbë të dëgjohen këshillat amerikane dhe atyre që pohojnë se tarifat duhet të pezullohen vetëm me garanci për përfundimin e bisedimeve me Serbinë me njohje të ndërsjellë.

Meta: Jemi në krizë, palët të reflektojnë

TIRANË, 4 MARS - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, deklaroi se vendi është në një krizë politike kushtetuese dhe institucionale dhe se për këtë duhet dialog mes palëve.

Gjatë konferencës që pati me presidentin e Sllovenisë, Meta tha se palët duhet ta rivendosin normalitetin politik, pasi vendi është në pritje për hapjen e negociatave me BE-në. "Deklaroj se jemi në kushtet e një krize politike, kushtetuese dhe institucionale e cila mund dhe duhet të ishte shmangur. Në mënyrë të vazhdueshme kam apeluar për dialog, për t'i paraprirë atij vendimi të rëndësishëm që pritet që nga qershori për çeljen e negociatave. Palët të bëjnë hapa pas dhe të reflektojnë për të rivendosur normalitetin politik kushtetues institucional. Kur ka vullnet politik dhe nuk vihen interesat personale duhet të na shtyjë drejt zgjidhjeve të mençura me dialog", tha Meta.

Presidenti kërkoi nga palët që të bëjnë hapa mbrapa dhe të reflektojnë për të rivendosur normalitetin politik në vend. "Palët të bëjnë hapa pas dhe të reflektojnë me përgjegjshmëri për të rivendosur normalitetin politik në vend. Kur vihen në plan të parë interesat kombëtare, na shtyjnë drejt zgjidhjeve të mençura dhe zgjidhjes politike të kësaj situate", u shpreh Meta.

BE-ja shtyn për në vjeshtë vendimin për Shqipërinë?

TIRANË, 4 MARS - Më 20 dhe 21 qershor është përcaktuar që Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut të njihen me vendimin e vendeve anëtare të BE-së për hapjen ose jo të negociatave të anëtarësimit.

Por duket se ka një pasiguri që shoqëron këto data të rëndësishme për fatin e të dy vendeve, pasi në Bruksel dyshojnë nëse raporti do të publikohet në qershor apo do të shtyhet për në vjeshtë.

Duket se këto luhatje në mendime nuk varen aspak nga kriza politike në Shqipëri por nga zgjedhjet për Parlamentin Evropian që do të zhvillohen në muajin prill.

Sipas komisionarit për zgjerimin, Johanes Hahn, raporti i progresit për Shqipërinë dhe Maqedoninë do të shtyhet për shkak të frikës se çështja e zgjerimit mund të keqpërdoret nga partitë populiste në zgjedhjet evropiane.

Shtyrjen e datës së publikimit të progres-raportit, Hahn e konfirmoi në një deklaratë ku tha se debati për zgjedhjet e PE-së duhet të bëhet mbi fakte, por nuk konfirmoi shtyrjen e datës për dhënien e vendimit final. "Në këtë drejtim synojmë t'i shmangim të gjitha pengesat e mundshme që do ta vështirësojë debatin objektiv, neutral, i cili nuk duhet të preket nga zgjedhjet në Bashkimin Evropian. Mendojmë që publikimi të ndodhë më vonë nga e zakonshmja në mënyrë që debati për zgjerimin të bazohet në fakte. Në çdo rast do të publikohen para inaugurimit të Parlamentit të ri Evropian", tha Hahn.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka mbajtur mbledhjen e Kryesisë

Mustafa: E vetmja zgjidhje janë zgjedhjet e reja

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka vlerësuar se vendi ka hyrë në një qorrsokak dhe e vetmja rrugëdalje janë zgjedhjet e reja. Në një konferencë për medie, të mbajtur të hënën, Mustafa ka thënë se vetëm pas marrjes së legjitimitetit të ri nga qytetarët, institucionet e vendit do të mund t'i kryejnë detyrimet kushtetuese, duke përfshirë edhe dialogun me Serbinë. Sipas kreut të LDK-së, përgjegjësit kryesorë për situatën aktuale në vend janë president dhe kryeministri

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 4 MARS - Lideri i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka bërë me dije se vendi ndodhet në një gjendje të rëndë politike nga e cila mund ta nxjerrin vetëm zgjedhjet e parakohshme. Pas mbledhjes së Kryesisë së LDK-së, ai ka thënë se institucionet e vendit do të mund t'i kryenin obligimet e tyre kushtetuese vetëm pas marrjes së legjitimitetit të ri nga qytetarët e Kosovës. "Si LDK konsiderojmë se zgjidhja e vetme për të dalë nga ky qorrsokak është që të shkohet në zgjedhje. Që të marrin legjitimitetin para qytetarëve, dhe mbi bazën e këtij legjitimiteti, pastaj çdo institucion i Kosovës ta kryejë detyrën e vet edhe në fushën e dialogut, mbi bazën e përgjegjësive dhe obligimeve kushtetuese", ka thënë Mustafa në një konferencë për medie. Ai ka mohuar çdo mundësi që LDK-ja do të bashkëqeverisë me PDK-në në këtë mandat.

Sipas Mustafës, veprimet që i ka ndërmarrë ky koalicion qeverisës duhet t'i evitojë vetë. "Askush mos të mendojë në Kosovë se LDK-ja do të hyjë në qeveri në këtë mandat me PDK-në për të zëvendësuar AAK-në, ose për t'i shpëtuar ndytësitë e këtij koalicioni përmes LDK-së. Ne si LDK çdoherë i kemi marrë përgjegjësit për sjelljet dhe veprimet tona. Konsiderojmë se duhet të jemi shumë të kujdesshëm ndaj miqve tanë, në këtë rast ShBA-së dhe BE-së, për sjelljet tona dhe, po ashtu, do të jemi shumë të kujdesshëm për dialogun", ka thënë Mustafa, duke shtuar se dikush duhet t'i garantojë qytetarët e Kosovës për procesin e dialogut. "Duhet dikush t'i garantojë qytetarët e Kosovës se në procesin e dialogut nuk do të ketë korrigjim të kufijve. Dikush duhet t'i garantojë qytetarët se nuk do të ketë shkëmbim të territoreve dhe që nuk do të vihet në tavolinë Deklarata e Pavarësisë e datës 17 shkurt 2008. Çdo veprim yni te kufijtë dhe te territori na bie në situatë që ta zhbëjmë shtetin që e kemi shpallur. Kjo nuk mbrohet as me tarifë, as me tendenca që të shtyhen presidenti dhe kryeministri se kë po e thërret më shpesh Amerika dhe BE-ja, por mbrohet me vendime të forta të Kuvendit të Kosovës. Ne jemi shtet parlamentar dhe demokratik", është shprehur ai.

Për situatën aktuale në vend, i pari i LDK-së i ka bërë përgjegjës presidentin dhe kryeministrin e vendit. "Konstatuam se vendi është në një situatë shumë të rëndë, mos të them prej situatave më të rënda, për arsye joserioziteti dhe të garës politike që po bëjnë liderët institucionalë dhe ambiciet e tyre që po i prezantojnë para opinionit kosovar dhe ndërkombëtar, se kush është më i fortë. E kam fjalën për presidentin dhe kryeministrin", ka thënë Mustafa. Sipas tij, presidenti po sillet sikur Kosova me qenë pronë e tij, kurse kryeministri sikur është i vetmi person që vendos për taksën ndaj mallrave serbe.

Mustafa ka ftuar liderët institucionalë që të kenë kujdes në raportet me partnerët ndërkombëtarë. "Kemi probleme shumë të mëdha me partneritetin me BE-në dhe ShBA-në. Kurrë Kosova nuk ka qenë në situatë më të rëndë të partneritetit me ata që kanë ndihmuar në çlirimin e vendit dhe ndërtimin e këtij vendi. Ky është problem i papërgjegjësisë së institucioneve të vendit dhe të koalicionit qeverisës", është shprehur Mustafa.

Qeverisjen aktuale ai e ka vlerësuar si qeverisje të ish-komandantëve të UÇK-së. Mustafa ka thënë se nëse ata ia duan të mirën Kosovës duhet ta rrëzojnë sa më shpejt këtë qeveri. "Në momentin që kanë rrëzuar qeverisjen e drejtuar nga LDK-ja është themeluar qeveria e komandantëve, të cilët aktin e parë që kanë dashur ta bëjnë ka qenë që ta zhbëjnë Gjykatën Speciale. Do të thotë, ata i kanë pasur disa qëllime të veta pse e kanë rrëzuar qeverinë. Mirëpo tash ata duhet ta rrëzojnë vetveten, sepse ne nuk i kemi sjell ato vendime. Nëse e duan këtë vend, këta duhet që nesër ta shpërbëjnë Kuvendin dhe të shkojmë në zgjedhje të re. Nëse nuk e duan këtë vend, ata shahen gjithë ditën, kurse në mbrëmje e ndajnë pazarin dhe vazhdojnë edhe me tutje të ekzistojnë si koalicion", ka thënë ai.

I pari i LDK-së ka folur edhe për mundësinë e rrëzimit të kësaj qeverie nga opozita. "Lidhur me mocionin, ne si LDK po bëjmë përpjekje maksimale që së bashku me opozitën, e unë opozitë e konsideroj LV-në, që ta rrëzojmë qeverisjen aktuale. Kur ta shohim mocionin se pse PDK-ja do rrëzimin e qeverisë ne vendosim. Kjo nuk është qeverisje e AAK-së dhe Ramush Haradinajt. Kjo është qeverisje e PDK-së. PDK-ja së pari duhet ta rrëzojë vetveten. Për rrëzimin e PDK-së çdoherë jemi gati", ka thënë Mustafa.

Bekim Jashari pret në takim kryeparlamentarin Kadri Veseli

SKENDERAJ, 4 MARS (ER) - Kryetari i komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka pritur të hënën në takim kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli. Përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", Jashari ka thënë se pati kënaqësinë që së bashku me nënkryetarin Nuredin Lushtaku ta presë në zyrë kryeparlamentarin Kadri Veseli, deputetin Bekim Haxhiu dhe bashkëpunëtorë të tjerë, në prag të shënimit të "Epopesë së UÇK-së". Jashari ka treguar se në këtë takim kanë diskutuar rreth aktiviteteve që do të zhvillohen për nder të 21-vjetorit të rënies heroike të komandantit legjendar Adem Jashari dhe Familjes Jashari si dhe për tema e çështje të tjera të interesit shtetëror. "Edhe në paraqitjen tonë të përbashkët para mediave e ritheksova nevojën për të qenë të bashkuar kur vihen në pyetje interesat dhe e ardhmja e shtetit tonë. Shembulli më i mirë për këtë është fitorja e shqiptarëve në Tuz të Malit të Zi", ka thënë Jashari.

Flet për "Epokën e re", Jakup Krasniqi

Pa epopenë e Jasharëve s'do

- 21 VJET PAS 'EPOPESË SË UÇK-së' FITORJA ËSHTË E MADHE, NDONËSE JO E PLOTË

Ish-zëdhënësi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), historiani Jakup Krasniqi, me rastin e shënimit të 21-vjetorit të 5, 6 dhe 7 marsit të vitit 1998, ka thënë se pa epopenë e Jasharëve në Kosovë nuk do të nxehte dielli i lirisë dhe pavarësisë. Për më shumë se dy dekada pas kësaj ngjarje të rëndësishme për vendin dhe kombin shqiptar, ai ka thënë se fitorja është e madhe, por jo e plotë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Krasniqi ka deklaruar se Prekazi i Poshtëm dhe Lagjja e Jasharëve janë bërë qendra të pelegrinazhit për të gjithë shqiptarët, ndërsa Adem legjendari kryesimbol i lirisë dhe i pavarësisë sonë. Ai ka thënë se është koha që institucionet shtetërore t'i kushtojnë vëmendje të shtuar dhe serioze Kompleksit Memorial "Adem Jashari", që është bazamenti i lirisë dhe i shtetit tonë

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 4 MARS - Ish-zëdhënësi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Jakup Krasniqi, ka thënë të hënën se pa ngjarjet pararendëse, e sidomos pa epopenë e Jasharëve legjendarë, në Kosovë nuk do të nxehte dielli i lirisë dhe pavarësisë sonë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se në këto ditë të gjitha rrugët e Kosovës të çojnë në Prekazin e Adem Jasharit. "Prandaj nuk është rastësi pse Prekazi i Poshtëm, Lagjja e Jasharëve, është bërë qendra e pelegrinazhit për gjithë shqiptarët kudo janë. Ndërsa Adem legjendari, kryesimbol i lirisë dhe i pavarësisë sonë.", ka deklaruar Krasniqi.

21 vjet pas kësaj ngjarje të rëndësishme për vendin dhe kombin shqiptar ai ka thënë se fitorja është e madhe, por jo e plotë. "Ajo që mund të thuhet tani është fakti se Kosova është e lirë, sovrane dhe e pavarur dhe kjo nuk është pak, por nuk është e tëra. Nuk është e tëra, se Jasharët dhe shumë breza para tyre kishin luftuar për çlirim dhe bashkim kombëtar, kishin luftuar për shtet të së drejtës në të cilin qytetarët e prekin dhe e jetojnë perspektivën e tyre. Kjo, mbase, u mbetet brezave të rinj të Shqipërisë e të Kosovës ta realizojnë. Gjithsesi, fitorja është e madhe, ndonëse jo e plotë", është shprehur Krasniqi. Ai ka thënë se është koha që institucionet shtetërore t'i kushtojnë një vëmendje të shtuar dhe serioze Kompleksit Memorial "Adem Jashari", që është bazamenti i lirisë dhe i shtetit tonë. "Kompleksit

Ndërtimi i Spitalit të Pediatrisë dhe Kirurgjisë së Fëmijëve po shkon drejt fazës së dytë

PRISHTINË, 4 MARS (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka bërë me dije të hënën se ndërtimi i Spitalit të Pediatrisë dhe Kirurgjisë së Fëmijëve ngadalë po hyn në fazën e dytë. "Ndërtimi i vrazhdë po shkon drejt përfundimit dhe së shpejti pritet nisja e punimeve në ambientet e brendshme", ka thënë Ismaili. Ai ka theksuar se Kosovës i ka munguar një spital për kirurgjinë e fëmijëve, i cili do t'i trajtonte të gjitha sëmundjet e tyre, pa pasur nevojë që ata t'i dërgojë jashtë vendit për kurim. "Spitali do t'i ketë hapësirë 10 mijë metra katrorë, 100 shtretër dhe pajisjet më moderne për trajtimin e fëmijëve", ka thënë Uran Ismaili, ministër i Shëndetësisë.



të kishim liri dhe pavarësi

Memorial të Jasharëve legjendarë i është dhënë një pamje fillestare, por jo ajo që do të dëshironim ta shihnim. Tani për tani puna që kërkon urgjencë është konservimi i objekteve të trashëgimisë kulturore dhe historike, i kullave të qëndresës historike të 5, 6 dhe 7 marsit 1998. Shpresoj dhe besoj se kjo do të ndodhë shpejt. Ato janë monumentet kryesore të Kompleksit Memorial dhe nuk duhet të lihen në atë gjendje. Koha është që institucionet e shtetit t'i kushtojnë një vëmendje të shtuar dhe serioze asaj që është bazamenti i lirisë dhe i shtetit tonë", ka theksuar Krasniqi.

Në këtë intervistë ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, ka folur edhe për zhvillimet politike dhe për bashkimin e faktori politik kur janë në pyetje interesat e shtetit dhe kombit. Ai ka thënë se kombi ynë në rrethana robërie di të mobilizohet si i ka hije, ndërsa në rrethana lirie di të jetë goxha i çakorduar. "E gjithë historia e kaluar e kombit tonë, më se një herë e ka konfirmuar, se pa një bashkim në shkallë sa më të gjerë, kombi ynë asnjëherë nuk ka realizuar kërkesat e qëllimet e tij. Po, si po duket, historia po flet se kombi ynë në rrethana robërie di të mobilizohet si i ka hije, ndërsa në rrethana lirie di të jetë goxha i çakorduar, si jemi në vitet e fundit. Edhe ky vit po e konfirmon këtë gjendje", theksuar ai, duke shtuar se rrjedhat politike nuk janë aspak të mira.

"Epoka e re": *Z. Krasniqi, në këtë përvjetor të 'Epopesë së UÇK-së,' si i vlerësoni rrjedhat politike, ekonomike dhe sociale në vend?*

Krasniqi: Në ditë të tilla ndoshta më tepër duhet të flasim për ngjarjen që e solli kthesën e madhe sesa për gjendjen e sotme. Rrjedhat politike janë këto që janë dhe nuk janë aspak të mira. Nuk janë të mira në krahasim me të djeshmen kur gjithçka bëhej për interesin e kombit e të vendit, ndërsa sot shumëçka bëhet për interesat personale të atyre që kanë marrë e janë zotuar për përgjegjësinë publike për kombin dhe shtetin. Derisa qytetarët tanë perspektivën e shohin në ikje nga atdheu, kjo flet më së miri se as gjendja ekonomike e as ajo sociale në këtë vend nuk është e mirë. Për të ndryshuar gjendja, duhet ta ndryshojmë qasjen tonë për vendin dhe kombin.

"Epoka e re": *Z. Krasniqi, sot (e martë) shënohet 21-vjetori i 'Epopesë së UÇK-së'. Si e kujtoni këtë ngjarje dhe cila është rëndësia e saj për Kosovën dhe kombin shqiptar?*

Krasniqi: Fundviti 1997 dhe fillimviti 1998 ishin të mbushur me ngjarje të cilat paralajmëronin një luftë të pabarabartë të popullit tonë në raport me forcat pushtuese serbe. Ishin shenja që tregonin se lufta çlirimtare nuk ishte larg. Në një situatë të tillë ndodhën Likoshani dhe Qirezi, ku armiku në mënyrë barbare vrau dhe masakroi çfarë gjeti përpara. Në një atmosferë të tillë dhimbje kombëtare, ndodhi epopeja e Prekazit legjendar, një luftë e pabarabartë e një familje me shtetin, me makinerinë e tij ushtarake, policore të të gjitha llojeve. Nuk e di, nëse ajo luftë mund ta ketë një motër edhe në historinë e përbotshme. Sigurisht se ato ngjarje pas vetes kanë lënë lavdinë e tyre, kanë lënë dhimbjen krenare të kombit, pa të cilat nuk do të frymonim të lirë në atdheun tonë. Ishin ditë që askush nuk mund të dinte se cili do të ishte fati i tij. Në ditë të tilla njerëzit e shohin nevojën e mobilizimit për liri. Kështu nisi një mobilizim i ri i kombit tonë për luftën çlirimtare. Prandaj nuk është rastësi pse Prekazi i Poshtëm, Lagjja e Jasharëve, është bërë qendra e pelegrinazhit për gjithë shqiptarët kudo janë. Ndërsa Adem Legjendari, kryesimbol i lirisë dhe i pavarësisë sonë. Pa ngjarjet pararendëse, e sidomos pa epopenë e Jasharëve legjendarë, në Kosovë nuk do të nxehte dielli i lirisë e i pavarësisë sonë. Prandaj, në ditë të tilla, të gjitha rrugët e Kosovës kanë të çojnë në Prekazin e Adem Jasharit.

"Epoka e re": *Lufta e Jasharëve më 5, 6 dhe 7 mars të vitit 1998 është sakrifica më sublime për liri. Është realizuar plotësisht ajo për të cilën është flijuar familja Jashari?*

Krasniqi: Në këtë pyetje çdo përgjigje ka vështirësi. Pse? Së pari, çdo luftë për liri rrënjët i ka në idealizmin e shumë brezave atdhetarësh, që kulmoj më 5, 6 dhe 7 mars 1998 në Prekazin e trimërive tradicionale. Së dyti, veprat që burim kanë idealizmin, janë më shumë sesa vështirë që të realizohen, pa formësimin e idealeve të jetësimit të ëndrrave shekullore. Idealet gjithnjë ecin para nesh dhe gjithnjë kanë nevojë për idealizma të rinuara, të përtërira e të ripërtërira. Ajo që mund të thuhet tani është fakti se Kosova është e lirë, sovrane dhe e pavarur dhe kjo nuk është pak, por nuk është e tëra. Nuk është e tëra, se Jasharët dhe shumë breza para tyre kishin luftuar për çlirim e bashkim kombëtar, kishin luftuar për shtet të së drejtës në të cilin qytetarët e prekin dhe e jetojnë perspektivën e tyre. Kjo mbase u mbetet brezave të rinj të Shqipërisë e të Kosovës ta realizojnë. Gjithsesi, fitorja është e madhe, ndonëse jo e plotë.

"Epoka e re": *Pavarësisht prej sakrificës dhe madhështisë së veprës së Jasharëve, dy dekada më pas Kompleksi Memorial 'Adem Jashari' në Prekaz është në gjendje jo të mirë. Pse shteti nuk u përkujdes si duhet dhe në kohën e duhur për të ruajtur këtë tempull të shenjtë?*

Krasniqi: Kompleksit Memorial të Jasharëve legjendarë i është dhënë një pamje fillestare, por jo ajo që do të dëshironim ta shihnim. Tani për tani puna që kërkon urgjencë është konservimi i objekteve të trashëgimisë kulturore e historike, i kullave të qëndresës historike të 5, 6 e 7 marsit 1998. Shpresoj dhe besoj se kjo do të ndodhë shpejt. Ato janë monumentet kryesore të Kompleksit Memorial dhe nuk duhet të lihen në atë gjendje. Koha është që institucionet e shtetit t'i kushtojnë një vëmendje të shtuar dhe serioze asaj që është bazamenti i lirisë dhe i shtetit tonë.

"Epoka e re": *Ky përvjetor a duhet të shërbejë për bashkimin e faktorit politik për të punuar në interes të shtetit dhe kombit shqiptar?*

Krasniqi: E gjithë historia e kaluar e kombit tonë më se një herë ka konfirmuar se pa një bashkim në shkallë sa më të gjerë kombi ynë asnjëherë nuk ka realizuar kërkesat e qëllimet e tij. Po, si po duket, historia po flet se kombi ynë në rrethana robërie di të mobilizohet si i ka hije, ndërsa në rrethana lirie di të jetë goxha i çakorduar si në vitet e fundit. Edhe ky vit po e konfirmon këtë gjendje.

"Epoka e re": *Z. Krasniqi, në këtë përvjetor të 'Epopesë së UÇK-së', si i vlerësoni rrjedhat politike, ekonomike dhe sociale në vend?*

Krasniqi: Në ditë të tilla ndoshta më tepër duhet të flasim për ngjarjen që e solli kthesën e madhe sesa për gjendjen e sotme. Rrjedhat politike janë këto që janë dhe nuk janë aspak të mira. Nuk janë të mira në krahasim më të djeshmen kur gjithçka bëhej për interesin e kombit e të vendit, ndërsa sot shumëçka bëhet për interesat personale të atyre që kanë marrë e janë zotuar për përgjegjësinë publike për kombin dhe shtetin. Derisa qytetarët tanë perspektivën e shohin në ikje nga atdheu, kjo flet më së miri se as gjendja ekonomike e as ajo sociale në këtë vend nuk është e mirë. Për të ndryshuar gjendja, duhet ta ndryshojmë qasjen tonë për vendin e kombin.

Në Kazermën 'Adem Jashari' sot mbahet ceremonia ushtarake në nderim të 'Epopesë së UÇK-së'

PRISHTINË, 4 MARS (ER) - Në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë sot (e martë), në orën 11:00, mbahet ceremonia ushtarake në nderim të 21-vjetorit të "Epopesë së UÇK-së". "Ju ftojmë ta përcillni ceremoninë ushtarake të FSK-së për nder të 21- vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në kujtim të komandantit legjendar Adem Jashari, familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve të kombit, si dhe të gjithë të rënëve për liri dhe pavarësinë e vendit dhe popullit tonë. Ceremonia e manifestimit për 'Epopenë e UÇK-së' mbahet nën organizimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës", është thënë në njoftimin për media të Ministrisë së Mbrojtjes.

KHAIA publikon raportin me rekomandime për rastin e Dushit ku humbën jetën tre presona

Prishtinë, 4 mars (ER) - Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA), Organi për Hetimin e Aksidenteve Hekurudhore, ka përfunduar raportin e hetimit të aksidentit hekurudhor të trenit të udhëtarëve nr. 761 me automjetin rrugor në vendkalimin Dush të Komunës së Klinës, që ndodhi më 3 shtator të vitit të kaluar dhe ku humbën jetën tre persona dhe tre të tjerë u lënduan. "Më 3. 9. 2018, në orën 17:44 minuta, në vendkalim të rregullt të linjës së hapur hekurudhore në drejtimin Prishtinë - Pejë (në km 47+938.8), në fshatin Dush të Komunës së Klinës, treni i udhëtarëve, që qarkullonte në relacionin Prishtinë - Pejë, ka goditur një automjet të udhëtarëve. Si pasojë e aksidentit ka ardhur deri te vdekja e tre udhëtarëve dhe lëndimit të tre udhëtarëve të tjerë të automjetit. Gjithashtu, kishte dëme të mëdha materiale në automjetin e përfshirë në aksident", është thënë në raportin e KHAIA-së, Organi për Hetimin e Aksidenteve Hekurudhore.

Në këtë raport thuhet se deri tek aksidenti ka ardhur pasi vetura ka dalë në kryqëzimin e vijës hekurudhore me infrastrukturën rrugore në të njëjtin nivel, në të njëjtën kohë kur po kalonte edhe treni i udhëtarëve. "Shkaku kryesor i aksidentit serioz është mosrespektimi i dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 32 / 5 shtator 2016, Prishtinë') nga ana e shoferit të automjetit", është theksuar në këtë raport.

Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA), Organi për Hetimin e Aksidenteve Hekurudhore, ka dalë me gjashtë rekomandime të sigurisë pas këtij rasti.

Një rekomandim është përcjell për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit dhe një për Departamentin Koordinues të Këshillit për Sigurinë e Komunikacionit Rrugor. "Organi për hetimin e aksidenteve hekurudhore, me qëllim të përmirësimit të sigurisë në sistemin hekurudhor, i ka lëshuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe

Transportit rekomandimet e sigurisë që: Duke marrë parasysh sjelljen joadekuate të shoferëve të automjeteve gjatë kalimit në vendkalime hekurudhore, është bërë shumë i shpeshtë mosrespektimi i Ligji Nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, prandaj Departamenti Koordinues i Këshillit për Sigurinë e Komunikacionit Rrugor t'i hetojë tërësisht format e ndryshme të sjelljes së shoferëve, shkaqet e një sjelljeje të tillë, si dhe të sugjerojë masa që do të kontribuonin në rritjen e nivelit të sigurisë në vendkalimet hekurudhore; dhe rekomandimi tjetër që Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit t'i përgatisë dhe nxjerrë aktet nënligjore të domosdoshme për sektorin hekurudhor dhe t'i paraqesë rregullat nacionale të obligueshme të sigurisë", thuhet në raport.

Edhe dy rekomandime janë përcjell edhe për menaxherin e Infrastrukturës "Infrakos Sh. A.", me qëllim të përmirësimit të sigurisë së sistemit hekurudhor. "Menaxheri i Infrastrukturës 'Infrakos Sh. A.' t'i zhvendosë në distancë të mjaftueshme shtyllat elektrike dhe të gjitha objektet e tjera në afërsi të vendkalimeve hekurudhore, në mënyrë që të mos paraqesin rrezik për transportin hekurudhor; dhe menaxheri i Infrastrukturës 'Infrakos Sh. A' t'i përditësojë dhe kur është e nevojshme të nxjerrë rregulloret e brendshme në përputhje me ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës", theksohet në raport.

Edhe për ndërmarrjen hekurudhore "Trainkos Sh. A." dhe për Komunën e Klinës është përcjell nga një rekomandim, me qëllim të përmirësimit të sigurisë së sistemit hekurudhor. "Ndërmarrja hekurudhore 'Trainkos Sh. A.' t'i përditësojë dhe, kur është e nevojshme, t'i nxjerrë rregulloret e brendshme në përputhje me ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës. Po ashtu, edhe Komuna e Klinës rregullisht duhet ta mirëmbajë brezin rrugor (bimët, shkurret) në afërsi të vendkalimit hekurudhor, me qëllim të përmirësimit të dukshmërisë", është theksuar në këtë raport të KHAIA-së, Organi për Hetimin e Aksidenteve Hekurudhore.

Këto janë rekomandimet e para që lëshohen pas luftës për sigurinë në hekurudha.

SBAShK-u do të dorëzojë padi për kompensimin e orëve të humbura

EPOKA E RE Qendresa RAMA

Prishtinë, 4 mars - Sindikata e Bashkuar për Arsim dhe Shkencë në Kosovë (SBAShK) ka bërë me dije të hënën se do të dorëzojë një padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë ndaj vendimit të ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyçi, për kompensimin e orëve të humbura gjatë grevës së mësimdhënësve. "Ju njoftojmë se sot më datë 4. 3. 2019, në orën 13:15, SBAShK-u do ta dorëzojë në Gjykatën Themelore në Prishtinë padinë ndaj vendimit Nr. 911 të datës 27. 2. 2019, i cili ka hyrë në fuqi më 1. 3. 2019, i nënshkruar nga ministri Bytyqi për kompensimin e orëve të humbura gjatë grevës", është thënë në njoftimin për media të SBAShK-ut.

Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë në Qeverinë e Kosovës, Shyqiri Bytyqi, kishte vendosur që orët e humbura mësimore gjatë grevës së mësimdhënësve, të mbajtur këtë vit, të kompensohen. Sipas MAShT-it, ditët e humbura të mësimit në institucionet e arsimit parauniversitar do të zëvendësohen fillimisht me pesë ditë të marra nga pushimi pranveror në prill të këtij viti, pesë ditë të shtuna do të zëvendësohen gjatë vitit shkollor 2018/2019 dhe pesë ditë të zgjatet përfundimi i këtij viti shkollor.

Mësimdhënësit më 14 janar nisën grevën, e cila zgjati tri javë, me kërkesën për rritjen e koeficientit të pagave për 30 për qind. Greva është ndërprerë pas marrëveshjes me institucionet përgjegjëse, se Ligji i ri për paga do ta përafrojë kërkesën e tyre.

50 të rinj përfitojnë nga MKRS-ja për punë praktike në Turqi

Prishtinë, 4 mars (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka pritur të hënën në takim drejtoreshën e agjencisë "Alba Berisha Conulting", Albana Berisha. Ky takim u zhvillua me qëllim të nënshkrimit të memorandumit të bashkëpunimit në mes të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe kompanisë "Ayyt Career", e përfaqësuar nga agjencia "Alba Berisha Conulting".

Ministri Gashi ka njoftuar se qëllimi i nënshkrimit të këtij memorandumi është realizimi i punës profesionale praktike të të rinjve në formë të punësimit sezonal të tyre në Turqi. "Me qëllim të avancimit të të rinjve tanë dhe krijimit të kushteve për të punuar në punë praktike në fushën e hotelerisë, sot nënshkruam këtë marrëveshje nga e cila do të përfitojnë shumë të rinj të vendit tonë e të cilët, përveç që do të paguhen për punën e tyre, do të kenë mundësi të krijojnë përvoja të reja në këtë fushë në Turqi dhe punë për të cilën në fund edhe do të certifikohen. Kjo u mundëson atyre të aftësohen profesionalisht në fushën e hotelerisë dhe të krijojnë kontakte të reja të nevojshme për ta", ka thënë ministri Gashi.

Ai ka bërë me dije se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit përkrah këtë program me 15 mijë euro. "Këto mjete dedikohen për 50 të rinj përfitues duke llogaritur koston nga 300 euro për person", ka treguar Gashi. Ministri Gashi ka thënë se përzgjedhja e studentëve përfitues për punë praktike gjashtëmujore në Turqi do të bëhet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Ministrja Hoxha: Nuk kemi humbur asnjë cent nga fondet IPA

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 4 MARS - Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka raportuar në Komisionin për Integrime Evropiane, ku ka prezantuar zbatimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) për vitin 2018, zbatimi i ERA-s për periudhën 2016-2019 dhe rritja e fondeve të BE-së për Kosovën. "Zbatimi i PKZMSA-së për vitin 2018 ka tejkaluar planet. Sipas marrëveshjes, ka qenë e paraparë që zbatimi të jetë së paku 60 për qind, ndërkohë që plani është tejkaluar në 68.23 për qind për vitin 2018", ka bërë me dije ministrja Hoxha, duke shtuar se gjatë vitit 2017 PKZMSA-ja është zbatuar 62.05 për qind. "Jemi të përkushtuar që gjatë vitit 2019 ta rrisim dinamikën e zbatimit të masave legjislative", është shprehur ministrja Hoxha. Ajo ka thënë se, pavarësisht prej rezultatit të mirë të nivelit të masave zbatuese, Ministrja e Integrimit Evropian do të përpiqet që edhe këtë dinamikë ta rrisë dhe t'i tejkalojë planet. "Tashmë kemi rishikuar PKZMSA-në 2019-2023 dhe kjo shumë shpejt do të miratohet në Qeveri. Sipas planeve me BE-në, zbatimi i PKZMSA-së për vitin 2019 pritet të jetë 70 për qind, ndërsa për vitin 2020 të jetë 80 për qind", ka thënë ajo.

Kurse sa i përket zbatimit të ERA-s për periudhën nëntor 2016 deri në janar 2019, rezultatet janë inkurajuese. "Niveli i zbatimit të ERA-s që nga fillimi i saj në nëntor 2016 e deri në fund të janarit 2019 është 71.85 për qind, pasi që 97 nga 135 veprime janë zbatuar plotësisht, ndërsa 38 prej tyre (28.15 për qind) janë në zbatim e sipër. Të dhënat tregojnë se deri më tani janë zbatuar plotësisht 10 nga 22 prioritete, ose 45.45 për qind e tyre, ndërsa 12 prioritete, ose 54.55 për qind e tyre, janë në zbatim e sipër.

Presim që gjatë vitit 2019 ta rrisim dinamikën e zbatimit të prioriteteve të ERA 2 dhe do të përpiqemi t'i tejkalojmë planet", ka theksuar ministrja Hoxha. Ajo ka shtuar se, ashtu sikurse te PKZMSA-ja, edhe zbatimi i mbi 70 për qind i ERA-s demanton plotësisht zërat se, kinse Kosova ka pasur ngecje në këtë drejtim. "Më lejoni t'i përgënjeshtroj të gjitha ato spekulime që po bëhen dhe që mund të bëhen, sepse Kosova nuk ka humbur as edhe një cent të vetëm nga fondet e BE-së. Përkundrazi, fondet e BE-së vetëm sa janë rritur", ka thënë ministrja Hoxha, duke argumentuar me radhë. "Me IPA 2016, Pjesa 2, është nënshkruar kontrata për mbështetje buxhetore për reformën e administratës publike në vlerë prej 25 milionë eurosh, kurse me IPA 2017, Pjesa 2, është nënshkruar kontrata për mbështetjen buxhetore për menaxhimin e financave publike në vlerë prej 25 milionë eurosh", ka thënë ajo. Po ashtu, ministrja Hoxha e ka informuar komisionin parlamentar se fondet e BE-së për Kosovën vetëm sa janë rritur.

IPA 2017 ka ndarë 73 milionë euro, IPA 2018 ka ndarë 90.5 milionë euro, kurse IPA 2019 - 2020 mbi 200 milionë euro. "Përpos fondeve të IPA-s, më lejoni t'ju informoj se Kosova përfiton fonde edhe nga Korniza Investive e Ballkanit Perëndimor (WBIF)", vuri në dukje ministrja Hoxha. Ajo ka pohuar se vetëm në këtë raund të aplikimeve, pra raundin e 21 të aplikacioneve në kuadër WBIF-së, vlera e projekteve infrastrukturore tejkalon shumën prej 250 milionë eurosh. "Vetëm ndërtimet e impianteve për trajtimin e ujërave të zeza, impianteve për ujë të pijshëm dhe kolektorë të ujërave nëpër qendrat e mëdha dhe të vogla të Kosovës tejkalojnë vlerën prej 400 milionë eurosh. Po ashtu, Ministria e Integrimit Evropian do ta fillojë rishikimin e listës prioritare të projekteve duke hapur rrugë për investime në projekte të mëdha infrastrukturore", ka deklaruar ministrja Hoxha.

Ministrja Hoxha u përgjigj edhe ndaj pyetjeve të parashtruara nga deputetët, anëtarë të komisionit parlamentar për integrime evropiane, rreth përqindjes së realizuar të MSA-së, fondeve të IPA-s, shfrytëzimit ë fondeve të BE-së si dhe vijimit të angazhimit për procesin integrues dhe liberalizimin e vizave.

Veseli: Asnjë qeveri nuk mund t'i rrezikojë raportet e shenjta me ShBA-në

PRISHTINË, 4 MARS (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, njëherësh lider i koalicionit qeveritar, Kadri Veseli, ka thënë të hënën në Mitrovicë se çdo qeveri që rrezikon raportet me ShBA-në dhe bazën e Bondsteelit mund të bjerë. "Të gjitha qeveritë mund të ecin e Bondsteeli jo. Asnjë qeveri nuk mund t'i rrezikojë raportet e shenjta me ShBA-në. Ju e keni vërejtur që unë jam tërhequr nga ky debat dhe po më vjen turp se si po e trajtojnë qytetarin tonë. Nuk bën kështu. Kemi obligime. Kushtetuta është dhe ligjet janë. Qytetarët e Kosovës dhe institucionet e mbrojnë sovranitetin dhe integritetin territorial të vendit tonë", ka deklaruar Veseli, duke shtuar se Serbisë do t'i përgjigjen ashtu si e meriton. "Me tarifë dhe me reciprocitet. Nuk duhet me marrë këtë pjesë si sherr të vetvetes, se e kanë tepruar disa duke e marrë si individuale. Askush nuk mund i vetëm ta mbrojë Kosovën. Kosova mbrohet nga të gjithë bashkërisht. Ne politikanët e kemi përgjegjësi për t'iu përgjigjur qytetarëve, Kushtetutës dhe ligjeve të cilat janë në fuqi. I shenjtë është sovraniteti i Kosovës", ka thënë Veseli, i cili ka propozuar kohë më parë që taksa të pezullohet për një periudhë 120 ditore, mirëpo po kundërshtohet nga kryeministri Ramush Haradinaj, i cili ka thënë të hënën në Gjilan se taksa e vendosur do të mbetet derisa të ketë njohje nga ana e Serbisë për Kosovën në kufijtë ekzistues. "Taksa nuk duhet të shërbejë si kushtëzim dhe se marrëveshja në mes të Kosovës dhe Serbisë brenda kufijve ekzistues është zgjidhja e të gjitha problemeve", ka thënë kryeministri Haradinaj.

LËVIZJA VETËVENDOSJE KËRKON PUNËSIM DHE PAGA TË DINJITETSHME PËR GRATË

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

Prishtinë, 4 mars - Në kuadër të muajit të gruas, deputetja e Kuvendit të Kosovës, njëherësh anëtare e Kryesisë së Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, dhe anëtarja e Kryesisë, Tinka Kurti, kanë mbajtur të hënën konferencë për media lidhur me diskriminimin e punësimit të grave. Me këtë rast, deputetja Haxhiu ka thënë se gratë duhet të punësohen dhe të kenë paga të dinjitetshme dhe jo të diskriminohen e të shtypen. "Diskriminimi dhe shtypja, dhuna fizike she psikike, shfrytëzimi i vajzave dhe grave ka ndërlidhje të ngushtë me varësinë dhe shtypjen ekonomike. Në aspektin e legjislacionit janë bërë disa ndryshime, por të cilat kanë mbetur të pazbatuara", ka deklaruar Haxhiu. Ajo ka folur edhe për Projektligjin e punës të proceduar nga qeveria duke theksuar se nuk ka mekanizma mbrojtës kundër diskriminimit të grave në punësim, madje nuk ka asnjë autoritet ku mund të raportohen rastet. "Arsyet pse nuk punësohen gratë është sepse punëdhënësi e konsideron problem pushimin e lehonisë. Pushimi i lehonisë natyrisht se duhet të mbetet për periudhën njëvjeçare, por është koha ta ndajmë atë në formë të obligueshme, gjashtë muaj nëna, gjashtë muaj babai", ka theksuar ajo.

Edhe anëtarja e Kryesisë së Vetëvendosjes, Tinka Kurti, ka folur për diskriminimin që i bëhet gruas në rastet e punësimit. "Kur papunësia e grave është mbi 80 për qind, është e qartë se aty nuk bëhet fjalë për fat individual e as për përcaktim natyror. Ky është rezultat i politikave të gabuara e të dëmshme të shtetit. Dhe më e keqja është se këto shifra nuk janë të reja dhe nuk kanë shënuar ndonjë lëvizje që prej pasluftës. Pra, nuk bëhet fjalë për mospjesëmarrje, por për përjashtim", ka deklaruar Kurti.

KRYEMINISTRI PREMTON PËRKRAHJE FINANCIARE PËR GJILANIN

EPOKA E RE A. MAVRAJ

Gjilan, 4 mars - Kryeministri Ramush Haradinaj ka zhvilluar të hënën një vizitë pune në Komunën e Gjilanit, ku është pritur nga kryetari i kësaj komune, Lutfi Haziri. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj, i shoqëruar nga një pjesë e delegacionit qeveritar, ka thënë se gjatë vizitës në Gjilan, të cilin e filloi me kryetarin Haziri, biseduan për disa tema, disa prej të cilave ka pohuar se kanë avancuar.

Haradinaj ka thënë se Gjilanit ia kanë kthyer vëmendjen e duhur dhe me dinamikën e re qeverisëse po u japin jetë shumë projekteve të kësaj ane. "Impianti i ujërave të zeza shpejt do ta nisë fazën e implementimit dhe Qeveria do të jetë garanci e këtij investimi të rëndësishëm për këtë qytet. Punimet në autorrugët Gjilan - Prishtinë dhe Gjilan - Kllokot janë duke vazhduar në dinamikën e duhur derisa objekti i ri policor, Teatri i Qytetit dhe politikat e reja të subvencionimit të bimës që do t'i hapë rrugë zhvillimit ekonomik lokal, janë punë të tjera që i morëm përsipër së bashku me kryetarin Lutfi Haziri", ka thënë kryeministri Haradinaj. Sipas tij, Gjilani tashmë ka fondin prej 50 milionë eurosh për investime në kornizën afatmesme, që përfshinë pesë sektorë të rëndësishëm dhe bashkëveprimi për temat që lidhen me zhvillimin ekonomik do të jetë proces i vazhdueshëm. Njëkohësisht, kryeministri Haradinaj ka theksuar se për të gjitha temat që lidhen me zhvillimin ekonomik duhet të bashkëveprojnë edhe në nivelin kombëtar dhe komunal. "Gjithë qëllimi është që, përveç punëve të qarta, detyra që kemi marrë prej qytetarëve për zbatim të projekteve për një jetë më të mirë e njëkohësisht të jemi afër prodhuesve sipërmarrësve, të shënohen rritje të vendeve të punës, rritje të zhvillimit ekonomik", ka deklaruar kryeministri Haradinaj.

Ndërkaq kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, e ka falënderuar kryeministrin Haradinaj për, siç e ka quajtur ai, rikthimin në Gjilan, duke shtuar se kjo është vizita e dytë në komunë dhe e treta në Gjilan në cilësinë e kryeministrit. "Jemi në proces të zgjidhjes së një numri të madh të çështjeve që lidhen drejtpërdrejt me zhvillimin e komunës, duke i zgjidhur problemet nga më të ndryshmet", ka thënë Haziri.

KEK-u, ME MODERNIZIM TË 'KOSOVËS B', RRIT PRODHIMIN EDHE PËR 60 MEGAVATË

Prishtinë, 4 mars - Drejtori i Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), Njazi Thaçi, ka thënë se, edhe pse termocentralet e Kosovës janë të vjetra, ato mund të prodhojnë energji elektrike maksimum deri në 800 megavat. "KEK-u është ndërmarrje publike, Shoqëri Aksionare, në pronësi të Qeverisë së Kosovës. Duke e pasur parasysh se termocentralet e Kosovës janë shumë të vjetra, 'Kosova A' është lëshuar në punë para 60 vjetëve, kurse 'Kosova B" para 35 vjetëve. Maksimumi i prodhimit të dy termocentraleve është deri në 800 megavat, sasi kjo që është e pamjaftueshme për të gjithë konsumatorët e Republikës së Kosovës, sidomos në kohën e pikut. Sipas informatave, ngarkesa më e madhe në kohën e pikut shkon deri në 1150-1200 megavatë", ka thënë Thaçi në emisionin "Strike" në Radio Televizionin e Kosovës (RTK3).

Thaçi ka shtuar se në strategjinë e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) në pesë vjetët e ardhshëm parashihet rivitalizimi (modernizmi) i termocentralit "Kosova B", i cili do të fillojë në vitin 2020 dhe më 2021. Sipas tij, me modernizim të "Kosovës B", përpos që rritet prodhimi me 60 MG në blloqe, do të rritet edhe siguria në punë e tij. "Po ashtu, do të ndërrohen edhe elektrofiltrat dhe pjesa ambientale, e cila është investim nga BE-ja në vlerë prej 70 milionë eurosh. I gjithë investimi i përbashkët për këtë termocentral shkon deri në 250 milionë euro, duke përfshirë edhe pjesën ambientale", ka thënë ai.

Thaçi ka bërë me dije se janë duke hartuar dhe duke bërë studimin e fizibilitetit për hapjen e minierës së re, e cila do të furnizojë me thëngjill të dy këto termocentrale, në të ardhmen edhe Termocentralin e ri "Kosova e re", i cili pritet të ndërtohet dhe të lëshohet në përdorim pas pesë vjetëve. "Ne do ta bëjmë studimin e fizibiltetit edhe për prodhim të energjisë me panele solare. Në tokat e degraduara, ku nxirret thëngjilli, ne kemi paraparë, në një hapësirë prej 80 hektarëve, t'i vendosim panelet dhe të kemi prodhim të energjisë me panele solare", është shprehur ai. Sipas Thaçit, të gjitha kushtet janë aty për ta prodhuar këtë lloj të energjisë.

INICIOHET HAPJA E QENDRËS SË INOVACIONIT DHE NDËRMARRËSISË NË MITROVICË

Mitrovicë, 4 mars (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka iniciuar të hënën hapjen e Qendrës së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në Mitrovicë. Duke folur para qindra studentëve dhe profesorëve në Universitetin e Mitrovicës, ku do të jetë e vendosur qendra e inovacionit, kryeprlamentari Veseli ka thënë se çelësi i zhvillimit ekonomik qëndron te sektori privat, tek industria prodhuese, tek ekonomia e dijes dhe shkathtësive teknologjike. "Ky është vizioni ynë, vizioni më adekuat për ta çuar përpara vendin tonë, shtetin tonë, Mitrovicën tonë", ka thënë Veseli.

Kreu i Kuvendit të Kosovës ka pohuar se lajmi i sotëm i ka hije Mitrovicës, këtij qyteti të punëtorëve e të minatorëve, të studentëve e intelektualëve, të kulturës e të sipërmarrjes, të luftës për liri e të fuqizimit të shtetit. "Ne kemi një rini të talentuar, që e do punën dhe të ardhmen në vendin e vet, një rini të dashuruar pas teknologjisë informative. Kudo ku ka ide të mira, aty do të jetë përkrahja jonë. Për ne të rinjtë janë forcë krijuese. Ne duam t'i shohim të rinjtë që me talentin e tyre, me dijen dhe përkushtimin e tyre, krijojnë zhvillim, krijojnë vende të reja të punës, bëhen sipërmarrës të lirë", ka thënë Veseli.

Thellohet bashkëpunimi në mes të Bankës Qendrore të Kosovës dhe asaj të Turqisë

Ankara, 4 mars (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Fehmi Mehmeti, gjatë vizitës në Ankara, u prit nga guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Turqisë, Murat Çetinkaya. Në këtë takim, guvernatori Mehmeti ka informuar guvernatorin Çetinkaya lidhur me zhvillimet në ekonomi, veçanërisht në sistemin financiar të Republikës së Kosovës, duke potencuar stabilitetin makroekonomik dhe rolin e rëndësishëm të sistemit financiar për mbështetjen e rritjes së qëndrueshme të ekonomisë së vendit.

Dy guvernatorët diskutuan rreth bashkëpunimit ndërmjet Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe asaj të Turqisë, duke shprehur përkushtimin për ta thelluar bashkëpunimin në të gjitha fushat e përbashkëta. Me kërkesë të guvernatorit Mehmeti, guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Turqisë u zotua për ta mbështetur anëtarësimin e BQK-së në Klubin e Guvernatorëve për Azinë Qendrore, Rajonin e Detit të Zi dhe vendet e Ballkanit.

Anëtarësimi i BQK-së në këtë klub paraqet një mundësi të mirë për përforcimin dhe thellimin e bashkëpunimit me vendet anëtare, derisa mbështetja e Turqisë në këtë proces është shumë domethënëse, duke marrë parasysh faktin se Banka Qendrore e Republikës së Turqisë është një ndër bankat qendrore themeluese të këtij klubi.

Guvernatori Mehmeti shprehu edhe një herë mirënjohjen ndaj Bankës Qendrore të Republikës së Turqisë për mbështetjen dhe bashkëpunimin me zotimin, që niveli i bashkëpunimit mes dy bankave qendrore do të vazhdojë të rritet edhe në të ardhmen.

373 fëmijë kërkuan ndihmë në emergjencën pediatrike

Prishtinë, 4 mars (ER) - Në Emergjencën e Klinikës së Pediatrisë në Prishtinë është shtuar numri i fëmijëve që po kërkojnë ndihmë mjekësore. Sipas raportit të Klinikës së Pediatrisë, vetëm gjatë fundjavës kanë kërkuar ndihmë mjekësore 373 fëmijë me simptoma të ndryshme. Prej tyre 54 fëmijë janë pranuar për trajtim të mëtejmë në kuadër të Klinikës së Pediatrisë, meqë pediatrit kanë vlerësuar se iu nevojitet trajtim i mëtejmë shëndetësor.

Ministria e Infrastrukturës këtë vit do të nisë katër projekte të reja në Drenas

Drenas, 4 mars (ER) - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, ka bërë me dije të hënën se këtë vit në Komunën e Drenasit do të nisin së realizuari katër projekte. Ai ka thënë se me një buxhet të planifikuar 1 milion e 50 mijë euro sivjet, ndërsa vitin e ardhshëm 1 milion e 300 mijë, në Drenas do të fillojë ndërtimi i rrugës Vuçak - Tërdec, ndërtimi i rrugës transit Drenas - Kroni i Mbretit, ndërtimi i rrugës Gradicë - Zhilivodë dhe ndërtimi i rrugës së re Kroni i Mbretit - Liqeni i Vasilevës. "Përkushtimi ynë prek secilën komunë të Kosovës, pa dallim", ka thënë ministri Lekaj.

Universiteti 'Ukshin Hoti' arrin marrëveshje me Koordinatorin Nacional për Kulturë, Rini e Sport

Prizren, 4 mars (ER) - Ushtruesi i detyrës së rektorit në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren, prof. asoc. dr. Ismet Temaj, ka arritur marrëveshje bashkëpunimi me Rexhep Hotin, Koordinator Nacional në Qeverinë e Kosovës për Kulturë, Rini dhe Sport. Marrëveshja ka për qëllim avancimin e pozitës dhe përforcimin e kapaciteteve intelektuale të studentëve në kreativitet kulturor, mendim kritik dhe sport si dhe promovimin e bashkëpunimit të ndërsjellë në fusha të interesit të përbashkët të të dyja palëve. Përfaqësuesit e të dy institucioneve e vlerësuan lart arritjen e kësaj marrëveshje dhe u zotuan se do të përkushtohen për arritjen e objektivave.

Shkollat në Mitrovicë respektojnë vendimin e MAShT-it për kompensimin e orëve të humbura

Mitrovicë, 4 mars (ER) - Drejtuar nga kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, në prani të nënkryetarit Faruk Mujka, të hënën është mbajtur mbledhja e radhës e Bordit të Drejtorëve, në të cilën janë diskutuar dhe shqyrtuar çështje të rëndësishme nga fushëveprimi i bordit dhe drejtorive komunale. Në këtë mbledhje drejtori i Inspeksionit, Hysni Ahmeti, ka njoftuar ekzekutivin se është duke punuar për respektimin e orarit të punës të subjekteve afariste, ku me këtë rast tri ditët e fundit Drejtoria e Inspeksionit ka inspektuar lokalet të cilat nuk e respektojnë orarin e punës pas orës 23:00 pa leje dhe të dielën që është ditë pushimi. Ai ka thënë se është respektuar urdhëresa e drejtorisë së tyre dhe nuk kanë pasur telashe në këtë çështje. Po ashtu, gjatë kësaj mbledhje zyrtari kryesor financiar Adem Fazliu ka folur lidhur me raportin për shqyrtimin e pyetësorit vetëvlerësues, me ç'rast ka njoftuar se ky raport përgatitet në kuadër të pesë komponentëve kryesorë, që janë: mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informatat dhe komunikimi, si dhe aktivitetet e monitorimit.

Ai ka thënë se ky pyetësor përmban gjithsej 106 pyetje, prej të cilave kanë rezultuar me 246 poenë, gjegjësisht mesatarja e vlerësimit është 2.25 për qind. Ndër të tjera, Fazliu ka theksuar se në rritjen e performancës ka ndikuar edhe përgatitja e listës së rreziqeve gjatë vitit 2018, ndërsa Plani Zhvillimor Komunal dhe Kodi i Mirësjelljes, të cilat do të përgatiten gjatë këtij viti, do të ndikojnë në rritjen e performancës. Ndërsa drejtori i Arsimit, Iset Beka, ka bërë me dije se në shumicën e shkollave të komunës së Mitrovicës është respektuar vendimi i Ministrisë së Arsimit, duke filluar nga dita e shtunë, me kompensimin e ditëve të humbura si pasojë e grevës së personelit arsimor.

Kujdes me etikën kur raportohet për raste të ndjeshme

Nga Musa SABEDINI

Mos e harroni rastin e Hamdi Sopës, i cili është përshkruar me shkelje drastike të etikës dhe tani familja me të drejtë kërkon dëmshpërblim. Mos e harroni dhe keni parasysh se në 12 orët e para, pas vrasjes, mediat nuk preferohet ta japin identitetin e viktimës dhe as fotografi, sepse mund ta dëmtojnë rëndë procesin hetimor dhe t'i lëndojnë ndjenjat e familjarëve. Mediat fillimisht mund të merren me thelbin dhe të dhënat periferike të vrasjes, e në asnjë mënyrë të bëhen publike fotografi dhe shënime apo të dhënat e të vdekurit, viktimës.

Kam shkruar edhe më herët për mënyrat e raportimit nga situatat e ndjeshme, që cilësohen raste tragjike, vrasje, vrasje të rënda, aksidente me fatalitet, dhunime, e raste të tjera, ku preket apo lëndohet mënyra e raportimit.

Edhe vrasja e djaloshit nga Prishtina, që ndodhi tash së fundi, edhe vdekja tragjike e tre personave në Prizren, po edhe rasti i abuzimit të vajzës nga Drenasi, dëshmojnë se sa të papërgjegjshëm dhe jo etik po tregohemi karshi këtyre rasteve të ndjeshme që po përshkruhen me shumë gabime e lëshime fillestare në fushën e etikës.

Mediat duhet të kenë parasysh se ka shumë kritere dhe mënyra për të shkruar e hulumtuar dhe ka shumë mënyra që të bëjnë raportim të drejtë, duke mos e shkelur apo dëmtuar etikën.

Jo vetëm bazuar në literaturën profesionale që ekziston për mënyrat e raportimit nga këto raste, por edhe nisur nga përvoja dhe në veçanti duke u bazuar në preambulën e KMSHK-së ku jepen detaje se si nuk duhet të raportohet për rastet e ndjeshme, ne duhet të jemi të kujdesshëm që të ruajmë me mençuri dhe delikatesë rastet ku flitet për vrasje e tragjedi.

Publikimi i fotografisë së viktimës, publikimi i personit të dyshuar në 12 orët e para pas vrasjes paraqet shkelje të etikës, sepse 12 orët e para janë të rënda dhe të panjohura për familjarët e të dyja palëve, janë të rënda dhe me stres për familjen e viktimës e cila mund të bie nën ndikimin e këtyre lajmeve të shtrembëruara dhe të fryra.

Ne duhet të jemi të kujdesshëm që mos ta zmadhojmë asnjë version të ngjarjes, madje duke shmangur edhe motivin e vrasjes, përderisa ai nuk bëhet publik nga policia apo prokurori hetues i vendit të ngjarjes.

Pra çka do të ishte e lejueshme që mediat të trajtonin në storiet e tyre në 12 orët e para pas vrasjes. Media apo gazetari ka mundësi ose i lejohet që të merret me motivin e vrasjes, por duke specifikuar dhe duke qenë i saktë, që mund të jetë politik, me motive të ulëta, paraja, fajdeja e motive të tjera. Pastaj mund të jepni të dhëna kryesore, p.sh, që i vrari është nga Prishtina dhe është i moshës 27-vjeçare, që viktima është mashkull dhe është nga kjo lagje e Prishtinës.

Këto informacione nuk paraqesin ndonjë shqetësim të madh. Por shqetësim dhe me çdo kriter që qon në dëm të etikës në rastet e raportimit të vrasjeve të rënda paraqesin titujt të ilustruar edhe me fotografi, në stilin: "Ky është 27-vjeçari që u vra sot në Prishtinë" ose titulli tjetër: "Ky është personi që dyshohet se vrau…". Këta tituj janë të dëmshëm dhe lëndojnë familjarët dhe procesin e hetimit.

Për ta zhvilluar procesin e shkrimit dhe ngritur nivelin hulumtues pas 12 orëve, pra atëherë kur viktima varroset dhe atëherë kur gjakrat brenda familjes vijnë duke u "qetësuar" dhe sqaruar gjerat, gazetari i mirë, i sinqertë, i përkushtuar mund të nis një analizë apo hetim më të gjerë. Pra në 24 orët e ardhshme organet hetuese vetëm e kanë intervistuar të dyshuarin apo autorin e krimit dhe tani jeni më shumë të sigurt, me dokumente dhe deklarata në hetuesi dhe prokurori mund ta ndërtoni storien. Ju tashmë e dini se cili është motivi i vrasjes, sepse e keni deklaratën e të dyshuarit, ju i dini motivet që mund t`i thotë pala e dëmtuar, pra familja e të vrarit dhe gjithashtu nga këto të dhëna ju mund ta ndërtoni një tregim të balancuar për rastin konkret.

Edhe në këtë 24 orësh, vetëm nëse jeni të sigurt dhe në marrëveshje me policinë apo prokurorin, mund ta botoni foton e viktimës, por në asnjë mënyrë në orët e para pas vrasjes. Në storien e gazetarit gjithashtu mund të shfrytëzohen dokumente, burime nga më të ndryshmet, deklarata të dëshmitarëve të rëndësishëm, mundësisht nga vendi i krimit, deklarata koncize të policisë, prokurorit hetues, që e ka parë vendin e ngjarjes dhe të gjykatësit paraprak, që i ka caktuar masën e paraburgimit të dyshuarit.

Është e pavend që në këso raste të raportohet për të dyshuarin si "vrasës", derisa ai ligjërisht konsiderohet i dyshuar deri në gjykimin e plotfuqishëm. Këto kritere të raportimit janë të njohura për shumë media të shkruara dhe ato që janë profesionale dhe vërtet nuk e kam të qartë pse nuk tregohet një minimum i etikës.

Gjatë gjithë kohës sa mediat e shkruara merren me raportimin nga situatat e ndjeshme, gjithmonë kemi parasysh dhe insistojmë tek e vërteta, sepse ky është edhe parimi i parë dhe më i debatueshmi.

Pra si ta zbulojmë të vërtetën rreth tragjedisë së ndodhur, aksidentit të rëndë me fatalitet, vrasjes apo vrasjeve tjera. Edhe raportimet nga vdekja e tre qytetarëve në Prizren, në një aksident trafiku, ishte për çdo kritikë, sepse kishte një sulm të panevojshëm të lajmeve të njëpasnjëshme. Vetëm përsëriteshin titujt dhe nuk thuhej asnjë e dhënë e freskët.

Çdo gazetar i ri apo edhe me përvojë synon që informacioni i tij mbi këto tragjedi apo vrasje, të jetë i vërtetë, sepse kur e themi qartë dhe saktë të vërtetën, atëherë kemi krijuar siguri personale, te vetvetja dhe siguri edhe tek lexuesi.

Nuk ka më mirë se media apo edhe gazetari i ngjarjes të tregohet i përgjegjshëm për atë që ka shkruar apo hulumtuar dhe nuk ka më mirë se brenda çdo shkrimi për rastet e ndjeshme të respektohen parimet e saktësisë, korrektësisë dhe objektivitetit.

Edhe tek këto raste të raportimit do të duhej të vlente thënia amerikane: "Nëse edhe nëna të thotë të dua, verifikoje".

Zakonisht kur ndërtojmë ose raportojmë për ngjarje të rënda, ne kemi parasysh verifikimin e çdo lloj burimi. Pra duhet të kemi kujdes nga burimet dhe ata që na flasin apo rrëfejnë për ngjarjen. Kur ngjarja është e ndërlikuar apo me hollësira teknike, është mirë që reporteri t`iu kthehet fakteve, duke mos bërë supozime.

Në të gjitha librat apo materialet që lidhen me rastet e raportimit nga rastet e vrasjes, është e pëlqyeshme që autori i shkrimit të marrë parasysh këto të dhëna: Emri dhe adresa e viktimës (ose viktimave), koha dhe vendi i ngjarjes, arma e krimit (nëse është e mundur), shkaku zyrtar i vdekjes, kush e ka gjetur trupin e viktimës, hulumtimi për gjurmët dhe motivet e vrasjes, komentet dhe deklaratat e policisë, prokurorit, avokatëve, miqve dhe fqinjëve, pastaj nëse viktima ka qenë e evidentuar në polici (a ka pasur dosje të hapur), cilat janë pasojat e vrasjes për familjen, miqtë, bashkëpunëtorët afarist etj.

Nëse policia ka arrestuar dorasin (vrasësin), atëherë duhet të mbledhim këto të dhëna: Emri, mosha dhe adresa e të arrestuarit, të dhënat për viktimën, akuza e saktë dhe motivi i krimit, rrethanat e arrestimit, ku gjendet i arrestuari, a kishte dosje të hapur në polici etj.

(Autori është gazetar me përvojë dhe ligjërues në Degën e Medias dhe Komunikimit në UBT)

Hiqet lista e pritjes për sintigrafi

Prishtinë, 4 mars - Lista e pritjes për Scintigrafi në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) është hequr pas vendimit për shërbim 24 orësh. Scintigrafia është një lloj i veçantë i procedurës së mjekësisë nukleare që përdor sasi të vogla të materialit radioaktiv për të diagnostikuar dhe vlerësuar seriozitetin e një sëre sëmundjesh, duke filluar nga ato të skeletit, zemrës, mushkërive, mëlçive etj. Ministria e Shëndetësisë dhe Shërbimi Spitalor Klinik Universitar po angazhohen në mënyrë që gjatë vitit 2019 të hiqen listat e pritjes edhe për shërbimet e tjera që ofrohen në QKUK.

Drejtori i Shërbimit Klinik të Njësisë Nukleare, Fakir Spahiu, ka thënë se me miratimin kujdestarive pacientët marrin shërbimin brenda një jave. "Pas miratimit të kujdestarive, në bashkëpunim me drejtorin e Përgjithshëm të ShSKUK-së, kemi marrë vendim që nga 1 dhjetori i vitit 2018, ta fillojmë shërbimin e kujdestarisë dhe për tre muaj e kemi hequr listën e pritjes. Domethënë, listë të pritjes në Shërbimin Klinik të Njësisë Nukleare nuk ka. Shërbimet e të gjitha scintigrafive që kërkohen ne i kryejmë brenda një jave", ka thënë Spahiu.

Gjatë muajit janar, pas heqjes së listës së pritjes, në QKUK janë kryer 85 scintigrafi të eshtrave, 12 të veshkave, pesë të mushkërive dhe 80 të gjëndrës tiroide. Në bazë të raportit të punës, vetëm gjatë kujdestarive, për një muaj, janë ofruar 197 shërbime të scintigrafisë.

ShBA-ja mbyll zyrtarisht konsullatën në Jerusalem

Uashington, 4 mars - Shtetet e Bashkuara e mbyllën të hënën zyrtarisht konsullatën në Jerusalem, duke e ulur nivelin e misionit kryesor diplomatik për palestinezët, me hapjen e Ambasadës amerikane në Izrael. Për dekada me radhë konsullata në të vërtetë ka funksionuar si ambasadë për palestinezët. Tani aktiviteti i konsullatës do të realizohet nga një njësi e veçantë diplomatike për palestinezët, nën drejtimin e ambasadës.

Ky ndryshim simbolik ua kalon autoritetin kanaleve diplomatike të Shteteve të Bashkuara me Bregun Perëndimor dhe Gazën, ambasadorit David Friedman, mbështetës për sigurimin e fondeve për krijimin e vendbanimeve hebraike në Bregun Perëndimor dhe një kritik i ashpër i udhëheqjes palestineze.

Njoftimi për mbylljen e konsullatës u bë të hënën në mëngjes nga Departamenti i Shtetit në Jerusalem dhe po të hënën filloi aktivitetin njësia e re.

Kur lajmi për zhvendosjen e konsullatës u njoftua për herë të parë nga Sekretari i Shtetit Mike Pompeo në tetor, ai shkaktoi zemërim te palestinezët, duke nxitur dyshimet e tyre se ShBA-ja po njihte me këtë veprim kontrollin e Izraelit në territoret e Jerusalemit lindor dhe të Bregut Perëndimor, ku palestinezët duan ta kenë shtetin e tyre të ardhshëm.

Vitin e kaluar ShBA-ja njohu Jerusalemin kryeqytet të Izraelit dhe e zhvendosi ambasadën e vet atje, me një veprim që përmbysi politikën amerikane për njërën prej çështjeve më të vështira në konfliktin në mes të izraelitëve dhe palestinezëve.

Hetime për lidhje të mundshme të presidentit Trump me Rusinë

Ligjvënësi Jerrold Nadler tha se ka në plan të kërkojë të dhëna për 60 persona, përfshirë zyrtarë të Shtëpisë së Bardhë dhe Departamentit të Drejtësisë, si pjesë e hetimeve të zgjeruara ndaj presidentit Donald Trump mbi lidhjet e tij të mundshme me Rusinë gjatë fushatës presidenciale të vitit 2016

Uashington, 4 mars - Kryetari i Komisionit Juridik në Dhomën e Përfaqësuesve ka në plan të kërkojë të dhëna të hënën për 60 persona, përfshirë zyrtarë të Shtëpisë së Bardhë dhe Departamentit të Drejtësisë, si pjesë e hetimeve të zgjeruara ndaj presidentit Donald Trump mbi lidhjet e tij të mundshme me Rusinë gjatë fushatës presidenciale të vitit 2016.

Ligjvënësi Jerrold Nadler i tha kanalit "ABC News" se komisioni dëshiron të shohë dokumente të djalit të madh të presidentit Trump, Donald Trump Jr. dhe Allen Weisselbergut, shefit financave të Organizatës Trump, perandoria globale e biznesit të presidentit. "Krimet dhe shkeljet e padëshirueshme që mund të çojnë në shkarkim nga detyra janë dy gjëra të ndryshme: Mund të ketë krime që nuk janë shkelje që mund të çojnë në shkarkim dhe e kundërta. Ne duhet t'ia parashtrojmë këtë popullit amerikan - dhe nuk mund të varemi nga hetimi i Robert Muellerit për këtë: hetimi i Muellerit, së pari nuk e dimë se kur do të përfundojë, pavarësisht prej thashethemeve të shumta dhe, së dyti, është përqendruar në krime specifike. Ne duhet të përqendrohemi në një hetim më të gjerë", tha ai.

Komisioni në fjalë dhe grupe të tjera në Kongres po presin publikimin e raportit të prokurorit të posaçëm Robert Mueller mbi hetimin e tij 22-mujor për lidhjet e mundshme të fushatës Trump me Rusinë dhe nëse Donald Trumpi, si president, pengoi drejtësinë duke u përpjekur ta pengonte hetimin.

Ligjvënësi Nadler thotë se beson se ish-avokati personal i presidentit Trump, Michael Cohen, ka implikuar drejtpërdrejt presidentin në krime të ndryshme si gjatë fushatës së tij presidenciale edhe sa ka qenë president.

Ish-avokati Cohen i tregoi javën e kaluar Komisionit të Mbikëqyrjes në Dhomën e Përfaqësuesve dy çeqe - një të nënshkruar nga presidenti dhe një të nënshkruar nga djali i tij dhe financieri Weisselberg - për ta rimbursuar pjesërisht avokatin për 130 000 dollarët që ai i pagoi pak para zgjedhjeve të viti 2016 yllit pornografik Stormy Daniels për ta mbajtur atë të heshtur në lidhje me një marrëdhënie të dyshuar që ajo pretendon të ketë pasur me Donald Trumpin më shumë se një dekadë më parë.

Cohen është dënuar me burgim për tre vjet pasi u shpall fajtor për krime financiare dhe për dëshmi të rreme në Kongres lidhur me përpjekjet e Trumpit për biznes në Rusi që përfunduan në janar 2016, në fillim të fushatës së tij presidenciale.

Putini e nënshkruan tërheqjen nga pakti bërthamor me ShBA-në

Moskë, 4 mars - Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, e ka nënshkruar dekretin e suspendimit të traktatit për armët bërthamore me ShBA-në, që daton nga Lufta e Dytë Botërore, raporton "Reuters". Rusia pati thënë muajin e kaluar se do ta suspendojë traktatin pasi Shtetet e Bashkuara fillimisht thanë se do të tërhiqen nga marrëveshja.

Uashingtoni e ka akuzuar Rusinë për shkeljen e saj me krijimin e raketës 9M729.

Moska e mohon se raketa në fjalë është në kundërshtim me marrëveshjen.

Ditë më parë sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka thënë se NATO-ja duhet të jetë e përgatitur për një botë pa këtë traktat dhe me më shumë raketa ruse. "Raketat e reja ruse kanë kapacitet bërthamor. Ato mund të arrijnë në qytetet evropiane, janë të vështira për t'u vërejtur andaj është e rëndësishme të vazhdojmë t'i bëjmë thirrje Rusisë të veprojë në përputhje me paktin", pati thënë Stoltenbergu.

Traktati është nënshkruar në vitin 1987 nga presidenti i atëhershëm i ShBA-së, Ronald Reagan, dhe udhëheqësi sovjetik Mikhail Gorbachev.

Traktati, i cili ka eliminuar një klasë të tërë të raketave nga Evropa, konsiderohet kyç për stabilitetin strategjik në mes të Uashingtonit dhe Moskës.

ShBA-ja rikthen nivelin e raporteve diplomatike me BE-në

Uashington, 4 mars - Shtetet e Bashkuara thanë se e kanë rikthyer misionin e Bashkimit Evropian në Uashington në statusin e tij të mëparshëm, duke e quajtur BE-në si një nga "partnerët e saj më të vlefshëm". Në fund të vitit të kaluar, ShBA-ja e uli statusin diplomatik të misionit të BE-së nga "shtet anëtar" në "organizatë ndërkombëtare". Ky veprim u vlerësua si një goditje më shumë në raportet e trazuara transatlantike. "Departamenti i Shtetit do ta njohë përsëri përfaqësimin e Bashkimit Evropian në Uashington si të barasvlershëm më atë të një misioni dypalësh", tha ambasadori i ShBA-së në BE, Gordon Sondland. Sipas tij, BE-ja është një organizatë me rëndësi të veçantë dhe një nga partnerët më të vlefshëm të ShBA-së në çështjet e prosperitetit dhe sigurisë botërore. "Bashkëpunimi dhe niveli i angazhimit dypalësh duhet të njihen në të gjitha nivelet pasi siguria dhe suksesi i Evropës janë të lidhura ngushtë me atë të ShBA-së", tha ambasadori Sondland.

Vitet e fundit raportet në mes të ShBA-së dhe BE-së janë përkeqësuar. Administrata e presidentit Donald Trump vitin e kaluar vendosi tarifat për çelikun dhe aluminin ndaj BE-së.

BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.

E rrallë

Shtëpizat në liqenin Ontario, tërësisht të ngrira

Pronarët e shtëpive që ndodhen në liqenin Ontario, në bregun jugor të tij, thonë se nuk kanë parë kurrë një gjë të tillë. "Është e tmerrshme", ka pohuar për "NBC" "News Maureen Whelan", teksa pa shtëpinë e saj të pushimeve, tërësisht të mbuluar nga një shtresë e trashë akulli. Zona e plazhit, e quajtur

'Ramona', ndodhet midis Kingstonit dhe Syracuses në Nju Jork. Whelan thotë se përgjatë viteve moti kurrë nuk ka ndikuar në këtë zonë kështu si këtë vit.

FOTO E DITES

Një insekt fluturon mbi një lule gjatë temperaturave të pranverës në Erfurt të Gjermanisë. /AP/

E jashtëzakonshme

Gjenden 1 500 breshka të lidhura me rrip në valixhe

Policia në Filipine ka zbuluar më shumë se 1 500 breshka të gjalla të mbështjella me rrip brenda valixheve në aeroportin e Manilas. Breshkat, e gjetura në valixhet e braktisura në aeroport, kanë një vlerë në total prej 86.631

dollarësh. Policia dyshon se transportuesi i braktisi pasi zbuloi dënimet e ashpra që përballen trafikantët e kafshëve të egra.

BARSOLETA E DITËS

Një plakë, duke ecur rrugës, i sheh disa djem të rinj duke marrë drogë. Pa ditur çfarë është ajo, i pyet:
- Çka po bëni ashtu?
- Po marrim drogë.
- Veç mos rrini ul shumë aty, loke, se ftoheni!

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 14:00

"SHEEP AND WOLVES" 3D



I Animuar/Aventure/Komedi; 1 ore 25 min

Rolet: Graham Halstead, Vladimir Chuprikov
Regjia: Vladimir Nikolaev

Vetem gjate vikendit në ora 16:00

"ALITA: Battle Angel" 3D

Aksion/Aventure/Romanse; 2 ore 02 min

Rolet: Rosa Salazar, Christoph Waltz, Jennifer Connelly, Mahershala Ali, Ed Skrein, Jackie Earle Haley, Keean Johnson, etj.
Regjia: Robert Rodriguez

Në ora 18:00

"BERLIN, I LOVE YOU"

Dramë/Romansë; 2 ore

Rolet: Keira Knightley, Helen Mirren, Luke Wilson, Mickey Rourke, Jenna Dewan
Regjia: Dianna Agron, Peter Chelsom, Claus Clausen

Në ora 20:00 dhe 22:00

""SERENITY"

Dramë/Triller; 1 orë 46 min

Rolet: Matthew McConaughey, Anne Hathaway, Diane Lane, Jason Clarke, Djimon Hounsou, Jeremy Strong, etj.

Regjia: Steven Knight

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

DASHI
Fillimi i ditës ju gjen të mbingarkuar me punë. Do të donit disa ditë pushim, por kjo do të mbetet thjesht ëndërr në sirtar.

DEMI
Edhe pse duket se dita nuk do të mbyllet mirë, vetëm me një komunikim të shpejtë me partnerin, do t'i jepni zgjidhje gjithçkaje.

BINJAKËT
Sot do t'ju realizohen të gjitha ëndrrat për karrierën dhe financat e mira. Fati po ju ndihmon më shumë sesa që duhet.

GAFORRJA
Do të keni disa debate të nxehta me partnerin për këndvështrimet e ndryshme me të cilat i shikoni gjërat.

LUANI
Doni të ndryshoni disa gjëra që i përkasin rutinës suaj të përditshme. Edhe ju vetë do ta keni pak vështirë në fillim të ambientoheni.

VIRGJËRESHA
Sot mbrëmja është shumë e këndshme si për një takim dashurie, po ashtu edhe për një mbledhje mes miqsh, duke shijuar biseda interesante.

PESHORJA
Të gjitha vendimet tuaja sot do të kenë referencë një person të caktuar. Jeni në rrugën e duhur dhe i vetëdijshëm çfarë po bëni.

AKREPI
Sot dita ka uljet dhe ngritjet e veta dhe ju jeni në mes tyre duke përballuar çdo situatë mjaft mirë.



SHIGJETARI
Dita e sotme do të jetë e mbushur me takime dhe marrëveshje që nuk është se do të japin ndonjë zgjidhje përfundimtare për problemet tuaja.

BRICJAPI
Sot do t'i befasoni të gjithë me reagimin tuaj të cilin nuk e priste askush. Duke qenë zakonisht të mbyllur e të qetë, shpërthimi i sotëm do të jetë çlirim.

UJORI
Nuk jeni të qetë sepse shumë çështje varen nga ju sot. Doni të bëni një zgjidhje sa më korrekte, por kjo gjë influencon në humorin tuaj.

PESHQIT
Jeni të shpërqendruar sot sepse po i mbyllni gjërat e rëndësishme në sekondë të fundit. Kjo ju ka vënë nën presion.

Jessica Simpson kthehet në shtëpi pas qëndrimit njëjavor në spital

Jessica Simpson është aktualisht e qetë pas shtrimit në spital. Aktorja 38-vjeçare ka shkruar në "Instagram" për të treguar se ka qëndruar një javë në spital pasi u diagnostikua me bronkit. "Pas një jave në spital për bronkit, unë jam më në fund në shtëpi. Kollitja ka qenë një udhëtim i dhimbshëm. Unë po bëhem gjithnjë e më e shëndetshme. Edhe foshnja është mirë. Dashuri për të gjithë ata që u luten për mua", ka shkruar Jessica. Ajo aktualisht është shtatzënë, pret fëmijën e tretë me bashkëshortin Eric Johnson.

Taylor Swift paralajmëron këngë të re



Taylor Swifti është parë duke dalë nga një studio të dielën në Beverly Hills, Kaliforni. Fansat po mendojnë se këngëtarja 29-vjeçare është duke përgatitur muzikë të re pasi ajo iu drejtua atyre se shumë shpejt mund të sjellë një këngë të re.

Motrat Hadid shkëlqejnë në Javën e Modës në Paris

A to janë ndër dy modelet më të famshme në industrinë e modës. Motrat e njohura, Gigi dhe Bella Hadid, dukeshin të mrekullueshme gjatë Javës së Modës në Paris të dielën. Gigi kishte bërë një kombinim interesant me një fustan me nuanca interesante dhe një palë çorape të gjata, ndërsa Bella dukej elegante e veshur, me një fustan të zi dhe një xhaketë lëkure.

Madona ndryshon "look"

Edhe pse nuk është hera e parë, Madonna ka ndryshuar "look". Këngëtarja, 60 vjeçe, ka postuar disa fotografi ku shfaqet me kaçurrela dhe pastaj në një fotografi të madhe me hënën e kuqe, të cilën pati mundësi ta shikonte para disa javësh. Së shpejti, popstarja kameleonike duhet të zbulojë disa detaje mbi albumin e ri, titulli i të cilit duhet të jetë "Magic" dhe, ndoshta, transformimi i saj mund të ketë diçka të bëjë me projektin e ri muzikor.

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	DORTMUND - TOTTENHAM	1	REAL - AJAX	1-1	DERBY - WIGAN	1

Halilaj, shtetit: Na krijo hapësirë, se kemi talent që përfaqësojnë Kosovën

Federata e Gjimnastikës dhe kryetari i saj, Besim Halilaj, kanë apeluar që sa më parë shteti të ndërhyrje për të krijuar kushte për përgatitjet e sportistëve. Sipas Halilajt, në sportin e gjimnastikës ka mjaft talent që mund ta përfaqësojnë denjësisht gjimnastikën e Kosovës në arenën ndërkombëtare

EPOKA E RE Liridon ZEQIRI

Prishtinë, 4 mars - "Për dy ditë me radhë, të shtunën dhe të dielën, Federata e Gjimnastikës e Kosovës ka mbajtur garat për femra dhe për meshkuj në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë. Garat e gjimnastikës çdo ditë e më shumë po bëhen më atraktive, me pjesëmarrje të shumë gjimnastëve e të gjimnasteve cilësore, mirëpo shqetësimi i tyre dhe yni, njëkohësisht sfidë për gjimnastikën, pingpongun, sportet luftarake, mbetet hapësira ku po ushtrohen këto sporte, në nënkatet e Pallatit të Rinisë, pa i plotësuar kushtet për stërvitje, aq më pak për organizim të garave", është shkruar në llogarinë e FGjK-së në "Facebook" të cilën e drejton Besim Halilaj, duke bërë me dije se: "Tapeti gjimnastikor ka

dimensionet 14 x 14 metra, ndërsa salla na mundëson shtrirjen e një të tretës së tapetit, e ku t'u bëhet vend pastaj veglave të tjera. Është koha që bashkërisht, me organet kompetente, të bëjmë një zgjidhje afatgjatë që këto sporte, edhe gjimnastika, ta kenë vendin e merituar", thuhet, ndër të tjera, në tekstin e publikuar në llogarinë e FGjK-së në "Facebook".

I kontaktuar nga "Epoka e re", kryetari Halilaj rreth kërkesës për krijimin e hapësirave, për të pasur suksese dhe për të arritur rezultate sportistët e këtyre fushave, ka dhënë këtë përgjigje: "Ministria e Kulturës, respektivisht Departamenti i Sportit, po edhe departamentet e sportit në institucione të tjera lokale, duhet të na ofrojnë hapësirë më të madhe për shfrytëzim siç është, për shembull, Salla e Sporteve '1 Tetori'. Aty mund t'i vendosim veglat sportive dhe hapësira është e mjaftueshme për të performuar, ushtruar dhe që më pas të jemi të përgatitur për të marrë pjesë në garat ndërkombëtare. Po ashtu, duhet ditur se çdo sport e ka rëndësinë e vet nëse ka interesim dhe shikues, sepse sportin e mban gjallë shikueshmëria. Ndërsa garat që i organizojmë ne, shikuesit, në veçanti prindërit e garuesve, nuk kanë mundësi t'i përcjellin për shkak të hapësirave të vogla në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve".

Vazhdojnë akuzat në mes të Prishtinës dhe Llapit, përmenden ndërtimtaria dhe kazinotë

"Epoka e re"

Prishtinë, 4 mars - Nënkryetari i skuadrës së Prishtinës, Afrim Muçiqi, i ka quajtur të pavërteta akuzat e Llapit në lidhje me atë se Prishtina i ka marrë nga Federata e Futbollit të Kosovës 38 mijë euro. Muçiqi e ka quajtur Batatinën njeri që nuk ka shumë lidhje me futboll dhe se është i ardhur nga ndërtimtaria. "Nuk është absolutisht e vërtetë që i kemi marrë 38 mijë euro. Le të këqyrë ai, Batatina a Zhatatina, s'po di qysh t'i them, skuadrën e vet. Ka ardhur nga ndërtimtaria në futboll. Federata e ka shlyer një borxh që ka pasur ndaj Prishtinës për të drejtat televizive", ka thënë Muçiqi për "SuperSport".

Nënkryetarit të Prishtinës i është kundërpërgjigjur drejtori i Llapit, Tahir Batatina. Ky i fundit nuk ka hezituar t'ia përmendë edhe

kazinotë Muçiqit. "I nderuar Afrim Muçiqi, unë nuk vij nga një familje që i fyej njerëzit, nuk vij nga një familje pa moral, nuk i përkas një familje që luajmë kockë dhe as bixhoz. Për këtë e di opinioni i gjerë shumë mirë, prandaj ndihem i lumtur dhe krenar para qytetarëve të vendit tim dhe shtetit tim", ka thënë Batatina. "E vërtetë se e menaxhoj një ndërmarrje të fuqishme, por profesionistët e udhëheqin, ndërsa menaxhimin e bëj unë dhe jam krenar për këtë sepse ne menaxhojmë edhe tri firma në shtetet moderne dhe evropiane, por me nder dhe respekt, duke i respektuar njerëzit, duke e ruajtur familjen dhe duke kontribuar për vendin. E vërtetë se zëri nuk na shkon që të këndojmë, bixhozi jo, kocka jo, e as bastoret jo sikurse ty. Këto t'i fali gjithë jetën", ka shkruar Batatina në "Facebook".

Tahir Batatina ia ka rikujtuar Muçiqit edhe kontributin që ka dhënë në luftën çlirimtare dhe më pas edhe në Forcat e Sigurisë së Kosovës.

Reali dhe Tottenhami pritet të konfirmohen në çerekfinale

Madrid, 4 mars (ER) - Kampioni i Evropës, Real Madrid, synon sonte (e martë) ta harrojë eliminimin nga Kupa dhe mbetjen edhe me larg titullit në La Liga pas dy humbjeve nga Barcelona në "Santiago Bernabeu", duke e eliminuar skuadrën e Ajaksit nga Liga e Kampionëve. Ndeshjen e parë Reali e fitoi me rezultat 2-1 dhe tash është afër kualifikimit në çerekfinale. Ndërsa Ajaksi, pas paraqitjes së mirë në ndeshjen e parë si vendës, do t'i provojë të gjitha shanset për ta befasuar Realin që në këtë edicion nuk ka treguar formën më të mirë. Në këtë ndeshje vendësit do të jenë pa kapitenin Sergio Ramos, kurse mysafirët mund të mos i kenë të gatshëm Lisandro Magallan dhe mesfushorin Carel Eiting. Në ndeshjen tjetër kualifikimin në çerekfinale e kërkon edhe skuadra e Tottenham Hotspurit, e cila e mposhti në ndeshjen e parë skuadrën e Borussia Dortmundit (3-0). Megjithatë, gjermanët njihen për shpirtin garues dhe vështirë se do të dorëzohen duke kërkuar të bëjnë mrekullinë dhe të kualifikohen tutje në garën më të fortë në futboll.

SONTE TAKOHEN:

21:00 Real Madrid - Ajax	(2-1)
21:00 B. Dortmund - Tottenham H.	(0-3)

14 karateistë e përfaqësuan Kosovën në Austri

Prishtinë, 4 mars - 14 karateistë të Kosovës kanë garuar gjatë fundjavës në garën Karate 1 Serisë A për Seniorë, të mbajtur në Salzburg të Austrisë. Suksesin më të madh e arriti Albulena Gërvalla, e cila javë më parë fitoi medaljen e bronztë në Kampionatin Evropian U-21. Gërvalla në Salzburg zuri vendin e nëntë nga 104 garuese, në kategorinë deri në 55 kilogramë. Ajo shënoi tri fitore, një në garat e rregullta, ndërsa dy në repesazh. Tri fitore realizoi edhe Alvin Karaqi, i cili mbetet në garë për ta fituar normën olimpike "Tokyo 2020". Ai në kategorinë -84 kg u ndal në luftën e katërt. Sukses të njëjtë shënoi edhe Valdrin Rashiti (-67 kg), që realizoi tri fitore. Durim Haziri (+84 kg) shënoi dy fitore, ndërsa me nga një fitore e mbyllën garën Elona Kolgeci (-61 kg) dhe Donita Elshani (-68 kg). Garuesit e tjerë pësuan humbje në luftën e parë. Herolind

Nishevci nuk mori pjesë në këtë garë.

Challandesi: Hadërgjonaj dhe Sadiku nuk vijnë për dy ndeshjet e ardhshme

Prishtinë, 4 mars - Florent Hadërgjonaj dhe Loret Sadiku nuk do të jenë pjesë e Përfaqësueses së Kosovës as për ndeshjet e marsit, kundër Danimarkës dhe Bullgarisë.

Kështu ka thënë trajneri i "Dardanëve", Bernard Challandes, në një intervistë për emisionin "Koha Shtesë" në "Super Sport Kosova". "Nuk e di pse dhe kush po flet kaq shumë për ta. Është raportuar shumë në rrjetet sociale se ata do të vijnë, por kjo nuk qëndron. Të them të drejtën kam shumë kontakte me lojtarë që duan të vijnë, por nuk mund të flas asnjëherë sepse mund t'ua prish planet atyre. Ajo që mund të them është se për dy ndeshjet e ardhshme nuk do të ketë asnjë futbollist të ri", ka thënë Challandesi.

Hasani kërkon bashkëpunim më të thellë me Genadijus Sokolovas

Prishtinë, 4 mars - Presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, ka pritur të hënën trajnerin e notit me famë botërore, Genadijus Sokolovas. Ky i fundit ndodhet prej disa ditësh në Kosovë, ku po ligjëron në seminarin e FINA-s (Federata Ndërkombëtare e Notit), për nivelin e dytë të kursit për trajnerë të notit, në të cilin, krahas trajnerëve nga Kosova, po marrin pjesë edhe trajnerë nga Shqipëria, Maqedonia, Greqia, Britania e Madhe, Brazili etj.

Ish-notari i njohur ka qenë drejtor i shkencave sportive, ku ka pasur rastin të punojë me elitën e notit, duke përfshirë kampionin e shumëfishtë olimpik, Michael Phelphs. Presidenti Hasani falënderoi mysafirin nga ShBA-ja për edukimin që po e bën për trajnerët në këtë kurs, duke shprehur mirënjohjen e thellë dhe përkrahjen e vazhdueshme të Komitetit Olimpik të Kosovës për Federatën e Notit të Kosovës. "Gjatë bashkëbisedimit presidenti Hasani kërkoi që bashkëpunimi i Federatës së Notit në Kosovë me ligjëruesin Sokolovas të thellohet edhe më shumë gjatë këtij viti dhe bashkërisht edhe me Komitetin Olimpik të Kosovës t'i mundësohet Sokolovit të vijë sërish gjatë muajit tetor në vendin tonë për ta vijuar edhe nivelin e tretë të trajnimit për trajnerë. Hasani e njoftoi Sokolovasin edhe me vendimin e Bordit Ekzekutiv të KOK-ut për ta përkrahur edukimin në kampe jashtë vendit të trajnerëve të sporteve të ndryshme në Kosovë, si dhe me organizimin e kurseve për trajnerë dhe administratorë të sportit", thuhet në njoftimin e KOK-ut.

Ndërsa Genadijus Sokolovas u shpreh mirënjohës për pritjen e bërë, duke shprehur përshtypjet e para se Kosova është vend me shumë talentë nëpër botë. Ai foli për rëndësinë që ka organizimi i kursit të nivelit të dytë, në të cilin po e bartë përvojën e vet te trajnerët e shumtë pjesëmarrës. I pranishëm në takim ishte edhe sekretari i përgjithshëm i Federatës së Notit të Kosovës (FNK), Astrit Haliti.

Hardeni mposht i vetëm Bostonin, Toronto dorëzohet në shtesë

